

## Këshilli Koordinues i QSPA-së zhvilloi mbledhjen e tij të parë



Sipas pikave të rendit të ditës, drejtoresha ekzekutive e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, znj. Diana Kastrati prezantoi funksionin dhe misionin që ka ky institucion për kryerjen e studimeve të specializuara në fushën e historisë, letërsisë dhe kulturës së komunitetit arbëresh, të cilët përbëjnë një pjesë të rëndësishme të historisë tonë shqiptare. Gjatë mbledhjes, anëtarët u njohën dhe miratuan rregulloren që përcakton organizimin dhe funksionimin e këtij Këshilli. Me rëndësi ishte edhe diskutimi për aktivitetet e planifikuara për t'u zbatuar gjatë këtij viti nga ky institucion kërkimor shkencor për Diasporën shqiptare.

## Nënshkruhet memorandumi i bashkëpunimit mes Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë



Drejtoresha ekzekutive e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, znj. Elona Bano zhvilloi një takim pune me presidentin e Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë, z. Fatmir Brahimaj, ku diskutuan për mundësinë e krijimit të lidhjeve mes profesionistëve shqiptarë të fushës së mjekësisë në Diasporë. Gjatë takimit u nënshkrua një memorandum bashkëpunimi për organizimin e veprimtarive të përbashkëta me qëllim nxitjen e mjekëve shqiptarë të Diasporës për të kontribuar në vendin e origjinës dhe krijimin e urave të bashkëpunimit ndërmjet mjekëve në Shqipëri dhe atyre në Diasporë.

## Takimi i Mësuesve në Diasporë



Qendra e Botimeve për Diasporën organizon Takimin e Mësuesve nga Diaspora më 14 mars në Tiranë. Ky aktivitet do të ndihmojë në njohjen, promovimin dhe fuqizimin e bashkëpunimit ndërmjet mësuesve të Diasporës dhe vendit amë. Takimi synon diskutimin e procesit të mësimdhënies në Diasporë, ndërtimin e urave të qëndrueshme të komunikimit me mësuesit e Diasporës, si përcjellës të rëndësishëm të gjuhës, traditës dhe kulturës shqiptare të brezat e rinj që jetojnë në mërgatë.

## KKD / Ardian Radovicka pjesë e ekspozitës "The Eagle's Journey"




Artistë të talentuar të Diasporës shqiptare në Kanada hapin ekspozitë me temë "The Eagle's Journey" në Galerinë e Arteve në Etobicoke të Torontos. Qëllimi i saj është prezantimi i veprave të artit figurativ dhe promovimi i vlerave të artistëve të Diasporës shqiptare në Kanada. Pjesë e ekspozitës ishte edhe anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës, z. Ardian Radovicka, i cili u prezantua me veprën e tij "Krijuesi". Punimi im kryesor në këtë ekspozitë është pa dyshim "Krijuesi". Gjithmonë më kanë pëlqyer në jetë sfidat. Dhe paraqitja e këtij punimi është një lloj sfide personale dhe artistike për të marrë përsipër të trajtoj diçka të veçantë universale siç është Krijuesi i Gjithësisë.", -ka shkruar ai në rrjetet sociale.

## KKD / Rosario Petta pjesë e ceremonisë së 70-vjetorit të Pro Loco



Kryetari i komunës Hora e Arbëreshëve dhe njëkohësisht anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës, z. Rosario Petta, mori pjesë në ceremoninë e zhvilluar për të shënuar 70-vjetorin e shoqatës "Pro Loco di Piana degli Albanesi" në Itali. Gjatë fjalës së tij, z. Petta shprehu mirënjohjen për bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe rëndësinë e kësaj shoqate në promovimin e vlerave në këtë komunë arbëreshe.

## Aplikacioni informues "Diaspora Shqiptare"



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

## "Raporto" problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

## Për të kontribuar në ndihmë të familjeve të prekura nga tërmeti



Kontributet vullnetare dhe ndihmat për familjet, mund të bëhen me shpejtësi në rrugë digjitale, në tre kategoritë e veçanta të hapura për grumbullimin e ndihmave në portalin "e-Albania".